

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Organizimi i panairit “Taverna e Adriatikut”

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**Kodi **79956000-0 - Shërbime të organizimit të panairove dhe ekspozitave**

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,153,325 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

PERLLOGARITJA E VLERES LIMIT TE KONTRATES

“Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr. 127 datë 16.04.2024. të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve”.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të bashkise të vitit 2023-2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentat lidhur me preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës në Bashkinë Durrës.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

1. **Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162**, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe:

a) çmimet e tregut

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Komisioni organizoi punën për Kërkimin dhe Grumbullimin e Informacionit mbi Çmimet Orientuese për shërbimin, objekt i këtij prokurimi;

Komisioni gjithashtu llogariti gjëndjen e shumës së vëne në dispozicion sipas **Vendimit të Këshillit Bashkiak** Nr. 195, Datë 22.12.2023 janë vënë në dispozicion për shërbim **1,400,000** lekë me **TVSH**.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

- 1. Listat e publikuara** nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e shërbimeve që kërkohen të prokurohen.
- 2. Institucione të tjera zyrtare** të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.

Grupi u mbështet: Në hetimin e tregut vendas.

Në përfundim, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit tregtar dhe pasi i përpunoi ato në një Tabelë Komplekse të Grumbullimit të Zërave të mallrave bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi se:

1. Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull:

Rezultoi të jetë: 1,153,325 neto pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Durrës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit , sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **400.000** lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe mbeshetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Shërben për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, me qellim për te pare aftesite financiare te operatoreve ekonomin

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin **2023** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë dy viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **200.000** lekë

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Stafi prej 3(tre) punonjësish të kualifikuar kërkohet për arsyen në rast defekti të kete shërbimi sa më të shpejte dhe cilesor për gjatë të gjithë kohës së mbulimit të garancisë.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht** _ **persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët

ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

.....
.....

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që kërkohen për realizimin e kontratës së furnizimit të mallrave, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

.....
.....
.....

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës)

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: “..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-07576-05-31-2024

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Organizimi i panairit “Taverna e Adriatikut”

5. Fondi limit: **1,153,325** (një milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **5 ditë**

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: **13.06.2024 Ora: 10:00**

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anetarët e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit